



Konferenca "Roli i Avokateve perpara Gjykatave Nderkombetare" – Burimi: Fondacioni i Avokateve Europiane

CCBE Info

N° 41
Prill 2015

Presidentja e CCBE, zj. Maria Ślżzak takon Komisioneren Europiane per Drejtesine, zj. Věra Jourová – Lancimi i Fondacionit te Avokateve Europiane – Qeveria e Mbreterise se Bashkuar pranon degjimin e komunikimeve avokat-klient – Prokurimi publik – ceshtje qe kane te bejne me zhvendosjen

PRESIDENTJA E CCBE MARIA ŚLŻZAK TAKOHET ME KOMISIONEREN PER DREJTESINE VĚRA JOUROVÁ

Mbledhja e zhvilluar me 23 Mars ne Bruksel ishte nje mundesi per te diskutuar ceshtje me rendesi per profesionin ligjor me Komisioneren e Drejtesise, Konsumatoreve dhe Barazise Gjimore.

Pjesemarresit adresuan keto ceshtje specifike:

Inisiativat europiane ne legjislacionin penal, propozimin lidhur me Zyren e Prokurorit Publik European, e ardhmja e E-Drejtesise, trajnimi i avokateve, iniciativat ne mbeshtetje te barazise gjimore, si dhe politiken e fqinjesis se Baashkimit European dhe stadin e shtetit ligjor ne Ukraine.

Me pas, Zj. Ślżzak ndau me Komisioneren shqetesimin e avokateve mbi pergjimin masiv, vecanerisht ate mbi komunikimet ndermjet avokateve dhe klienteve te tyre. Zj. Jourová kerkoi informacion lidhur me raste te pergjimeve te avokateve, si psh rastet e raportuara se fundmi ne Mbreterine e Bashkuar dhe Hollande. Palet rane dakort te mbahen ne kontakt te vazhdueshem dhe te vazhdojne te punojne se bashku.



INAGURIMI I FONDACIONIT TE AVOKATEVE EUROPIANE

Inagurimi I Fondacionit te Avokateve Europian u mbajt me 23 Prill 2015, gjate zhvillimit te nje konference nderkombetare **“Roli I avokateve perpara Gjykatave nderkombetare”**.

Foles te nivelit te larte nga gjykatat nderkombetare dhe tribunalet u mblodhen ne Hage per t’ju drejtuar nje audience te gjere: Gjyqtar Theodor Meron (President I Tribunalit Penal Nderkombetar per ish-Yugosllavine), Gjyqtar Alexandra Prechal (Gjykata e Drejtesise e Bashkimit Europian), Gjyqtar Daniel Nsereko (Tribunali I Vecante per Libanin), si dhe stafi nga Gjykata e Perhershme e Arbitrazhit si dhe Gjykata Europiane e te Drejtave te Njeriut.

Qellimi kryesor I Fondacionit eshte te zbatoje projektet si vlere e shtuar ne krijimin e sherbimeve per avokatet europiane mbi ceshtje te politikave te drejtesise ne Europe. Me tej, Fondacioni mund te zbatoje projekte te tjera te lidhura me objektiva si te Drejtat e Njeriut dhe Shtetin e se Drejtes.

Per me shume informacion: [\[Inagurimi I Fondacionit te Avokateve Europiane\]](#)

LIGJEBERESIT BIEN DAKORD MBI DIREKTIVEN E RE PER PASTRIMIN E PARAVE

Parlamenti Europian dhe Keshilli I Ministrave arriten nje marreveshje mbi rishikimin e direktives se trete mbi pastrimin e parave ((2005/60/EC) me 20 prill.

Teksti prezanton nje sere ndryshimesh lidhur me profesionin ligjor: keshillimi tatimor qe jepet prej avokateve eshte ne menyre eksplicite brenda qellimit te raportimit; perkufizimi I krimeve te renda tani I referohet krimeve tatimore; dhe entet e detyruara perfshire edhe avokatet, duhet te ruajne per te pakten 5 vite informacionin e nevojshem te siguruar prej klientit per arsye sigurie.

Roli I nje organi vete-rregullues (Dhome Avokatia apo Shoqeri Ligjore) tashme mbrohet sa I takon raportimit te instances se pare. Gjithashtu, Direktiva parashikon se Shtetet Anetare duhet te sigurojne mjetet dhe menyren nepermjet te cilave mund te arrihet mbrojtja e sekretit profesional, konfidencialitetit dhe privatesise.

Pas marrjes se miratimit te Parlamentit ne leximin e dyte, Shtetet Anetare do te kene 2 vite per te transportuar direktiven ne ligjin e brendshem.

QEVERIA ANGLEZE PRANON DEGJIMIN E KOMUNIKIMEVE AVOKAT-KLIENT

Konfidencialiteti I komunikimeve ndermjet avokatit dhe klientit eshte nje garanci themelore e nje procesi gjyqsor te paanshem dhe te drejte. Qeveria Angleze pranoi ne Shkurt se sherbimet e inteligjences kane monitoruar ne menyre te jashteligjshme bisedat te cilat mbrohen nga konfidencialiteti avokat-klient. Pranimi ndodhi pas dergimit te nje ceshtje

perpara Tribunalit te Hetimit e cila lidhet me torturen e pretenduar te dy shtetasve Libaneze nga agjentet Britanike dhe Amerikane ne vitin 2004.

Per me teper: [\[Mbreteria e Bashkuar pranon monitorimin e jashteligjshem te bisedave te cilat ligjerisht jane te mbrojtura nga parimi I konfidencialitetit\]](#)

PROKURIMI PUBLIK: CESHTJE ME TRANSPOZIMIN/TRANSFERIMIN

Direktiva 2014/24/EU e 26 shkurtit 2014 mbi prokurimin public shfuqizojn nje direktive te vitit 2004 dhe prezanton rregulla shtese mbi kontratat e prokurimit public.

Gjate procesit te rishikimit, CCBE theksoi nevojen per te ruajtur nje status te vecante ne sherbimet ligjore, vecanerisht ne “regjimin e

lehte”. Dhomat e Avokatisve te Frances ihin te parat qe vune alarmin lidhur me kete ceshtje.

Ne nje leter zyrtare te derguar Komisioneres se Tregut te Brendshem, zj. Elzbieta Bieńkowska ne Prill, Presidentja e CCBE zj. Maria Ślęzak terhoqi vemendjen mbi problemet e raportuara ne France si dhe ngriti shqetesimet se dhe

shtete te tjera anetare ne menyre te ngjashme mund te zgjedhin te mos e zbatojne sic duhet Direktiven. Komisioni Europian mund te filloj nje procedure zyrtare te shkeljes se saj, nese nuk gjehet nje zgjidhje; CCBE do te vazhdoje te monitoroj kete situatë ne Shtetet Anetare ne muajt ne vazhdim.

AKTIVITETE TE ARDHSHME

28-29/05/15: *Seanca Plenare e 123 e CCBE, ne Gdarisk – aktivitet I hapur per median.*